



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 74 prot.

Tiranë, më 19.01.2021

**VENDIM**  
**Nr.13, datë 19.01.2021**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË**  
**VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 170, DATË 07.12.2020**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 170, datë 07.12.2020, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ, kryer për verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në procedurën e transferimit të përhershëm të nëpunëses \*\*\*\*\*, në kuadër të ristrukturimit të Bashkisë Klos”.

**KONSTATOVA SE:**

Me anën e kërkesës së regjistruar me nr. 270 prot., datë 17.04.2020, Departamenti i Administratës Publike ka informuar Komisionerin në lidhje me ankesën e paraqitur nga nëpunësja \*\*\*\*\*, e cila ka ngritur pretendimin për shkelje të rregullave procedurale dhe të dispozitave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në zhvillimin e procedurës së transferimit të përhershëm për shkak ristrukturimi, nga pozicioni “Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimit Social”, në Bashkinë Klos.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri, ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti duke kërkuar nga institucioni i Bashkisë Klos të dërgojë gjithë dokumentacionin që disponon në lidhje me procesin e transferimit të nëpunëses.

Në përfundim të këtij hetimi administrativ procesi është përmbyllur me Vendimin nr.170, datë 07.12.2020, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ, kryer për verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në procedurën e transferimit të përhershëm të nëpunëses \*\*\*\*\*, në kuadër të ristrukturimit të Bashkisë Klos”.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Klos, me shkresën nr. 3260/3 prot., datë 28.12.2020, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin dhe në

pjesën arsyetuese të vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, Bashkia Klos, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht, me aktin nr. 3260/1 prot., datë 17.12.2020, “*Dhënie mendim*”, nëpunësja \*\*\*\*\* në zbatim të pikës 1, të vendimit paralajmërues ka dhënë mendimin me shkrim duke pranuar transferimin e saj të përhershëm në pozicionin “*Përgjegjës Sektori*”, në Sektorin e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, në Bashkinë Klos, kategoria e pagës III-a/1.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 170, datë 07.12.2020, të Komisionerit, “*Mbi përfundimin e hetimit administrativ, kryer për verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në procedurën e transferimit të përhershëm të nëpunëses \*\*\*\*\* në kuadër të ristrukturimit të Bashkisë Klos*”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Klos, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 170, datë 07.12.2020.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Klos dhe nëpunësja \*\*\*\*\*.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**